



# BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.8

Korrik 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

## Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

**I. Materiale të shqyrtuara e të miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më datën 19.6.2004**

### PROJEKTLIGJE

**Vendime të Këshillit të Ministrave për propozim projektligji Kuvendit.**

1. "Për sigurinë në anije dhe porte."

Me miratimin e këtij projektligji nga Kuvendi, do të plotësohet një detyrim ndërkombëtar dhe racional në fushën e sigurisë, duke synuar të krijojë bazën e nevojshme ligjore për fushën e transportit detar.

### VENDIME të Këshillit të Ministrave

1. "Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Zhvillimit të sistemit Shëndetësor Shqiptar."

Miratimi I Strategjisë ka për qëllim reformimin e thelle të sistemit shëndetësor, bazuar në modelët bashkëkohore, implementimi i të cilave kërkon ndryshimin e mekanizmave bazë të organizimit, financimit e menaxhimit, për të

*(Vijon në faqen 2)*

## Ftesë e Hapur për Bashkëpunim

Ministria e Ekonomisë në mbështetje të:

Ligjit Nr. 8810, datë 17.05.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom";

Ligjit Nr.9127, datë 29.07.2003 "Për disa shtesa në ligjin nr.8810 datë 17.05.2001 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom";

Ligjit Nr.9117, datë 24.07.2003, "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Armo Fier";

dhe të programit të punës së Qeverisë Shqiptare ka përgatitur draftin e paketës së akteve nënligjore për privatizimin e dy shoqërive të rëndësishme që funksionojnë në sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare,

*(Vijon në faqen 8)*

## Në këtë numër do të lexoni:

**1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave**  
faqe 1-3

**2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore**  
faqe 1

**3. Ftesë e Hapur për Bashkëpunim**  
faqe 1 dhe 8

**4. Nga punimet e Kuvendit për periudhën 16-30 qershor 2004**  
faqe 4-5

**5. Kalendari 2 javor i Kuvendit,**  
5 - 15 korrik 2004  
faqe 6-7

## Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë  
[www.parlament.al](http://www.parlament.al)

Këshilli i Ministrave  
[www.keshilliministrave.al](http://www.keshilliministrave.al)

Presidenca  
[www.president.al](http://www.president.al)

Bashkia e Tiranës  
[www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al)

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës  
[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Ministria e Punëve të Jashtme  
[www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)

Ministria e Shëndetësisë  
[www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

Ministria e Rendit Publik  
[www.mpo.gov.al](http://www.mpo.gov.al)

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit  
[www.mpvd.gov.al](http://www.mpvd.gov.al)

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit  
[www.mtt.gov.al](http://www.mtt.gov.al)

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

bërë të mundur sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kujdesit shëndetësor për popullatën.

2. Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit Shtetëror për planifikimin spitalor.”

3.”Për miratimin e procedurave, tarifave dhe masën e mbulimit të shërbimeve ekzaminuese unike, terciare të përfshira në sigurimin shëndetësor.”

4.”Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 15.2.2001 “Për miratimin e standarteve dhe kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të Punimeve të ndërtimit.”

5.”Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.197, datë 18.3.1996 “Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore.”

6.Ky ndryshim jep mundësinë dhe hapësirën nënligjore për krijimin e Institutit të ndërtimit, strukturë e domosdoshme dhe e nevojshme në disiplinimin e fushës së ndërtimit.

7.”Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.650, datë 12.12.2002 “Për likuidimin e pagave dhe të detyrimeve të prapambetura të ëmsh-ndërmarrjes së prodhimit të çimentos në Fushë-Krujë.”

8.”Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.56, datë 27.2.2992 “Për trajtimin me pagë dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve në SHISH”

9.”Për kriteret e dhënies dhe kohëzgjatjen e pushimeve në raste të veçanta, për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.”

10.”Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Degëve të Mobilizimit në qytetet Përmet dhe Tepelenë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.515, datë 18.7.2003 “Për miratimin e

listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes.”

11.”Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së malit të Zi, për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Udhëtarëve dhe mallrave.”

12.”Për një shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Integritit European, për pagesën e TVSH-së.”

Në kuadrin e programit PHARE 200 të BE-së, për projektin “Mbështetje për përgatitjen e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Pala Hollandeze ka ofruar financimin për disa pajisje me vlerë 78.000 euro, por ka kërkuar që TVSH-ja të paguhet nga institucioni përfitues, që është Ministria e Integritit European. Shuma për pagesë TVSH-je është 2.028.000 lekë. Kjo shumë shtohet në buxhet në zërin “Pagesë TVSH-je” në favor të Ministrisë së Integritit European.

13.Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për ATSH.”

Gjatë muajit maj 2004 mbledhet në Tiranë Asambleja e 13-të e AMAN-it (Agjensia e Lajmeve e Vendeve të Mesdheut) në të cilën ATSH është anëtare e Aleancës. Fondet e miratuara në buxhetin e shtetit për vitin 2004, janë të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e organizimit të këtij aktiviteti. Prandaj jepet një fond shtesë prej 2.500.000 lekësh nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

14.”Për lëjimin e Ministrisë së Shëndetësisë të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” për shërbimin e kolaudimit dhe shpërndarjes së medikamenteve e ,aterialeve të mjekimit”

15.Për miratimin në parim të memorandumit të mirkuptimit,

ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës së tensionit të lartë 400 KË Shqipëri- Mal i Zi.”

16.”Për pajisjen me mjedise pune të partisë “Lëvizja e Legalitetit.”

17.”Për dhënie ndihme financiare familjes së Allaman Nuh Derwishit, ish-polic, i vrarë në krye të detyrës.”

## II. Materiale të shqyrtuara e të miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më datën 25.6.2004

### PROJEKTLIGJE

#### VENDIME të Këshillit të Ministrave për propozim projektligji në Kuvend.

1.”Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2003”

Projektligji i lartpërmendur është paraqitur për miratim në zbatim të ligjit “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”

Në projektligj, tregohen të dhënat për të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, e buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të dhëna për deficitin e përgjithshëm të shtetit dhe burimet e tij të financimit.

2.Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen për adoptimin e buxheteve të njëjta për kontrollet teknike të mjeteve me rrota dhe të njohjes së ndërsjelltë të kontrolleve të tilla”. Marrëveshja ka për qëllim unifikimin e kushteve të kryerjes së kontrolleve teknike periodike të mjeteve e ndërsjelltë të këtyre kontrolleve nga shtetet palë në Marrëveshje.

3.”Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen “Për transportin Ndërkombëtar të Ushqimeve Delikate dhe Pajisjet Speciale që përdoren në këto transporte”.

(Vijon në faqen 3)

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 2)

Qëllimi i aderimit në këtë Marrëveshje është njehësimi i kushteve dhe i legjislacionit me parametrat e BE-së për transportin e mallrave që prishen shpejt dhe që kërkojnë trajtim të veçantë, duke përdorur pajisje speciale.

Gjithashtu do të rritet siguria e shëndetit të popullit në konsumin e mallrave delicate, do të rriten kërkesat për plotësimin e kushteve nga transportuesit e këtyre mallrave, si dhe do të përafrojnë legjislacionin tonë të transportit rrugor me atë të BE-së.

4."Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Europiane "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR) dhe protokollin e nënshkrimit."

## **VENDIME të Këshillit të Ministrave**

1."Për pagën minimale në shkallë vendi".

Në vitin 2002 paga bazë minimale u rrit rreth 24 përqind, ndërsa në vitin 2003, paga bazë minimale u caktua 10.000 në muaj.

Me vendimin e lartpërmendur, paga bazë minimale mujore, për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik e fizik

2.Për miratimin në parim të Konventës për kontrollin e duhanit" Konventa parashikon:

- Masa që lidhen me reduktimin e kërkesës dhe ofertës për duhan

- Mbrojtjen e mjedisit

- Strukturën për masat e kontrollit të duhanit që do të zbatohen nga palët në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar

- Detyrimet

- Kooperimin teknik dhe shkencor dhe komunikimin e informacioneve

3."Miratimi në parim të Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bankës Europiane për rindërtim dhe Zhvil-

limi dhe të Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e prodhimit të energjisë termike, Vlorë"

4.Miratimin e Rregullores për përshkrimin, procedurat e propozimit, të shqyrtimit dhe të dhënies së medaljeve të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë."

5.Për kriteret dhe masën e korrupsionit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur emërohet ose komandohet në detyrë jashtë vendbanimit të tij."

6."Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.605, datë 13.10.2001 "Për kurset e formimit profesional të kualifikimit e specializimit në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari".

7."Për lejimin e Ministrisë së Rendit Publik të Përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për prodhimin e municioneve."

8."Për lejimin e Ministrisë së Rendit Publik të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për riparimin e pistoletave model 54 dhe prodhimin e pjesëve të këmbimit."

9."Për lejimin e Ministrisë së rendit Publik të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për prodhimin e pjesëve të këmbimit të pajimeve të armatimit, lëndëve të pastrimit dhe riaprimin e automatikëve model 56."

10."Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ujësellsave ndaj KESH sha, për tremujorin e dytë të vitit 2004."

11."Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga rehabilitimi i segmentit rrugor Ura e Bunës-Muriqan."

12."Për dhënie mendimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar "Mbi

Dhomën e mjekëve veterinar dhe profesionin e mjekut veterinar."

13."Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Punëve të jashtëme, për përballimin e shpenzimeve financiare për kandidimin e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë në pozicionin e sekretarit të përgjithshëm të OSBE-së."

14."Për rishpërndarje fondesh buxhetore, ndërmjet Kryeministrisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtëme, për vitin 2004."

15."Për miratimin në parim të memorandumit të mirkuptimit për krijimin e forumit rajonal të nismës së migrimit, azilimit dhe kthimit të refugjatëve."

16."Për një shtesë në rregulloren e Urbanistikës."

Shtesa ka të bëjë me rregulloret dhe normat urbanistike dhe arkitektonike për personat me aftësi të kufizuara.

17."Për transferimin në pronësi të Bashkisë – Sarandë të mjediseve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.515, datë 18.07.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes."

19."Për lejimin e Ministrisë së Financave të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për përzgjedhjen e bankës Amerikane të Shqipërisë si banka agjente lokale e Qeverisë së republikës së Shqipërisë, për propozimin e strukturimit teknik dhe menaxhues të KESH-a-së dhe fuqizimit e sistemit Elektrik Shqiptar."

## **Pika 3 e rendit të Ditës;**

Informacion i Ministrisë së Shtetit për Koordinimin Zotit Marko Bello, lidhur me plotësimin e urdhërit të Kryeministrit nr.66, datë 3.3.2004 "Për ushtrimin e kontrollit mbi zbatimin e legjislacionit të shërbimit Civil në ministrinë e linjës dhe disa probleme në Këshillin e Qarkut Berat.

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16-30 QERSHOR 2004

## **1. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004” (miratuar në seancë plenare më datë 24.6.2004)**

Ky projektligj mbështetet në fondet suplementare të siguruar nga privatizimi i Bankës së Kursimeve, të cilat janë parashikuar të përdoren 50 për qind për uljen e huamarrjes së brendshme dhe 50 për qind për investime në sektorët, të cilët Qeveria i ka vlerësuar si prioritarë, siç janë arsimi, shëndetësia, transporti, furnizimi me ujë, turizmi, sistemi i kanalizimeve dhe rrugëve urbane, si dhe për financimin e shpenzimeve shtesë në pushtetin gjyqësor, si rrjedhojë e ndryshimeve të bëra gjatë këtij viti në fushën e drejtësisë.

Gjatë prezantimit të projektligjit në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, Ministri i Financave informoi deputetët për drejtimet kryesore të ndryshimeve në Buxhetin e Shtetit të vitit 2004, të cilat bazohen në prioritetet sektoriale të vendosura në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik e Social dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm. Gjithashtu, ai theksoi se projekti i buxhetit suplementar synon një shpërndarje gjeografike të burimeve që të mbështesë zhvillimin e zonave më të varfra të vendit. Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët e maxhorancës u shprehën dakord me ndryshimet e propozuara, të cilat sipas tyre bazohen në prioritetet qeverisëse për zhvillimin e ekonomisë

Deputetët e opozitës e kundërshtuan projektligjin, me argumentin që ai nuk parashikon burime për kompensimin e ish-pronarëve dhe të ish-të përndjekurve politikë.

Lidhur me këtë çështje, Ministri i Financave informoi deputetët se buxheti i këtij viti parashikon koston për ngritjen e strukturave përkatëse për zbatimin e ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, ndërsa fondi i kompensimit do të parashikohet në buxhetin e viteve pasardhëse. Për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë ai theksoi se Ministria e Financave dhe Qeveria po ndjek përgatitjen e kuadrit ligjor për këtë çështje, me synim që të hartojë një ligj me impakte të menaxhueshme dhe të përballeshme nga Buxheti i Shtetit.

Disa deputetë ngritën shqetësimin se mund të mos realizohet përdorimi i fondit të parashikuar në buxhetin suplementar për investime, për shkak të kohëzgjatjes së procedurave për prokurimin e fondeve. Disa prej tyre u shprehën se përdorimi i burimeve të buxhetit suplementar do të ishte më

efektiv dhe me pasoja pozitive nëse edhe këto fonde do të përdreshin për uljen e borxhit të brendshëm. Ministri i Financave sqaroi deputetët se një pjesë e fondeve të parashikuara për investime orientohen në vazhdimin dhe përfundimin e projekteve në vazhdim dhe se është rakorduar puna me ministrinë e linjës që projektet e investimeve për objektet e reja të jenë të gatshme në momentin e zbatimit të tyre, duke u mbështetur vazhdimisht në prioritetet në këtë sektor. Një çështje tjetër që u ngrit si shqetësim gjatë diskutimit të këtij projektligji ishte parashikimi i përdorimit të një pjese të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave për investime, gjë që mund të ndikojë në prishjen e strukturës së Buxhetit të Shtetit. Ministri i Financave sqaroi deputetët se përdorimi i një pjese të fondit rezervë për investime është parashikuar për të siguruar vazhdimësinë e punës në disa objekte të rëndësishme në proces, deri në bërjen efektive të fondeve nga donatorët.

Gjatë diskutimit disa deputetë bënë vërejtje për shpërndarjen gjeografike të burimeve buxhetore, e cila sipas tyre nuk i përgjigjet nevojave emergjente që kanë disa zona të vendit.

Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin, duke bërë disa ndryshime në zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të Buxhetit, të cilat synojnë rritjen e fondeve për shpenzime kapitale, duke parashikuar edhe burimet për sigurimin e këtyre të ardhurave.

## **2. Projektligji “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” (miratuar në seancë plenare më datë 17.6.2004)**

Ky projektligj synon të plotësojë kuadrin ligjor që do të bëjë të mundur mbrojtjen e tokës bujqësore, e cila ka pësuar dëmtime të konisderueshme si rezultat i faktorëve natyrorë dhe i ndërhyrjeve të paligjshme të subjekteve të ndryshme mbi të.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët u ndalën veçanërisht në nenin 10 të projektligjit, sipas të cilit krijohet fondi për mbrojtjen e tokës bujqësore me burim financimi të ardhurat që sigurohen nga taksa për tokën bujqësore. Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit propozoi që jo më pak se 40 për qind e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, e cila mblidhet nga komunat dhe përfshihet në të ardhurat e buxhetit të tyre, të përdoren për mbrojtjen e tokës bujqësore. Disa deputetë ishin të mendimit që të mos përcaktohet në ligj destinacioni i përdorimit të taksës për mbrojtjen e tokës bujqësore, pasi në kushtet kur pushteti vendor ka shumë probleme të tjera

*(Vijon në faqen 5)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16-30 QERSHOR 2004

*(Vijon nga faqja 4)*

emergjente dhe mbrojtja e tokës bujqësore i shërben perspektivës, do të humbasë interesi i strukturave të pushtetit vendor për mbledhjen e kësaj takse. Ky mendim u kundërshtua nga shumica e deputetëve, të cilët theksuan se përcaktimi me ligj i destinacionit të përdorimit të një pjese të të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore do ta verë pushtetin vendor para detyrimit të mbledhjes së kësaj takse dhe do të krijojë fondin e nevojshëm për mbrojtjen e tokës bujqësore, duke i shërbyer kështu zbatimit të ligjit.

Kuvendi diskutoi edhe për propozimin e Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit lidhur me vendosjen në ligj të kufirit prej 40 për qind të të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, të cilat do të përdoren për mbrojtjen e tokës bujqësore. Pas diskutimit, vendosja e këtij kufiri në ligj nuk u miratua nga shumica e deputetëve.

Në përfundim, Kuvendi vendosi të miratojë propozimin e Komisionit të Përhershëm të Bujqësisë dhe Ushqimit për këtë çështje, i cili i ve njësitë e qeverisjes vendore para detyrimit që të krijojnë në buxhetin e tyre fondin e tokës, me burime nga tatimi mbi tokën bujqësore, duke ia lënë kompetencën për miratimin e këtij fondi Këshillit të njësisë vendore, në mbështetje të rekomandimeve të Këshillit të Qarkut, si dhe të gjendjes së tokave në territorin e njësisë së qeverisjes vendore. Kuvendi miratoi edhe disa ndryshime të tjera në formulimin e neneve të projektligjit.

### **3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar (miratuar në seancë plenare më datë 24.6.2004)**

Projektligji ka për qëllim të ndryshojë nenin 12 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, në të cilin përcaktohen strukturat përbërëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, duke ia lënë kompetencën për miratimin e tyre Ministrisë të Rendit. Lidhur me këtë projektligj, në Komisionin e Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore dhe në atë të Rendit dhe SHISH-it, si dhe në seancë plenare u mbajtën dy qëndrime:

Deputetët e maxhorancës u shprehën dakord me projektligjin, i cili sipas tyre i shërben thellimit të reformave në Polici dhe përshtatjes së strukturës së saj me ritmet e zhvillimit të shoqërisë, luftës ndaj krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti, duke rregulluar në këtë mënyrë edhe një mospërputhje midis neneve 12, pika 2 dhe nenit 14 të ligjit nr.8553. Ata kërkuan riformulimin e projektligjit pa prekur përmbajtjen thelbësore të tij.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan projektligjin, me argumentin që ndryshimet e propozuara çënojnë organizimin e Policisë. Sipas tyre, duke ia lënë përcaktimin e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në kompetencë Ministrinë të Rendit, rritet ndikimi i politikës mbi këtë institucion. Një pjesë e tyre propozuan që struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë duhet të miratohet me ligj nga Kuvendi dhe të mos i lihet në kompetencë Ministrinë të Rendit, pasi i hapet rrugë precedentit që ai të krijojë në mënyrë arbitrare struktura të reja. Gjatë diskutimit nga deputetët e opozitës pati mendime që të mos bëhen ndryshime të pjesshme të këtij ligji, por ndryshime që përmirësojnë ligjin në tërësi, në funksion të problematikës së vendit dhe të standardeve të kërkuara nga Bashkimi Europian, pasi ndryshimet e pjesshme prekin balancën e kompetencave ndërmjet Ministrisë të Rendit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

Në përfundim, Kuvendi miratoi me shumicë votash projektligjin sipas riformulimit të Komisionit të Përhershëm të Rendit dhe SHISH-it, i cili në thelb përputhet me synimin e projektligjit të paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

### **4. Raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (mbajtur në seancë plenare më datë 28.6.2004)**

Në Raportin e mbajtur nga Inspektorja e Përgjithshme, Fatmira Laska, paraqitet një ekspozë e punës së institucionit që ajo drejton, duke filluar që nga përzgjedhja e inspektorëve të Inspektoratit të Lartë, e cila sipas saj është bërë në përputhje me ligjin “Për statusin e nëpunësit civil” dhe duke vazhduar me përcaktimin e rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë. Ajo informoi Kuvendin për krijimin e Inspektorateve të Ulëta, hartimin e akteve ligjore që do të bëjnë të mundur zbatimin e ligjit, rezultatet e verifikimit të deklarimeve të pasurive për periudhën 1995-2003, ku përmendi disa mangësi dhe mungesa në dokumentacion, si dhe për punën kontrolluese në Inspektoratet e Ulëta. Ajo shprehu angazhimin e institucionit që ajo drejton për realizimin e kontrollit të deklaratave të pasurisë për funksionarët e lartë.

Gjatë debatit të zhvilluar për këtë Raport, deputetët e opozitës e mbështetën atë, ndërsa deputetët e opozitës paraqitën një sërë mangësisht në zbatimin e ligjit, duke vënë theksin në pasaktësitë e deklarimeve të bëra nga disa zyrtarë të lartë.

# KALENDAR I

## 2 JAVOR (5 - 15 KORRIK 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

*E Hënë, datë 5.07.2004, Ora 18.00*

*-Seancë Plenare*

1. Miratimi i Programit të Punës të Kuvendit për periudhën deri më 29 Korrik 2004.
2. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.
3. P/Vendim "Për përbërjen e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e Rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të VENECIAS për përmirësimin e Kodit Zgjedhor".
4. Mocion për debat me Kryeministrin, kërkuar nga një grup deputetësh për problemin e medias.

*E Martë, datë 6.07.2004*

*E Mërkurë, datë 7.07.2004*

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve :

1. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e menaxhimit të integruar të ujërave dhe ekosistemit".

*-Komisioni i Ligjeve*

*-Komisioni i Jashtëm*

*-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

*-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit*

2. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për kushtet e regjistrimit të anijeve" (Gjenevë, 7 shkurt 1986).

*- Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)*

*-Komisioni i Jashtëm*

*-Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacioneve*

3. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për unifikimin e disa rregullave për transportin ajror ndërkombëtar".

*-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)*

*-Komisioni i Jashtëm*

*-Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacionit*

4. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e prodhimit dhe ristrukturimit të sektorit të energjisë".

*-Komisioni i Ligjeve*

*-Komisioni i Jashtëm*

*-Komisioni i Industrisë*

*-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

5. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit "Menaxhimi i mbledhjeve urbane të Tiranës".

*-Komisioni i Ligjeve*

*-Komisioni i Jashtëm*

*-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

*(e ka shqyrtuar)*

*-Komisioni i Shëndetësisë (e ka*

*shqyrtuar)*

6. P/Ligji "Për masat kundër financimit të terrorizmit"

*-Komisioni i Ligjeve*

*-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

*-Komisioni i Rendit*

7. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit" (paraqitur nga një grup deputetësh).

*-Komisioni i Ligjeve*

*-Komisioni i Shëndetësisë dhe Mjedisit*

8. Dekret nr.4251, datë 26.06.2004 për dhënie pëlqimi për emërimin e znj.Vitore Tusha në detyrën e Anëtares së Gjykatës Kushtetuese, në vend të gjyqtarit Zija Vuci.

*-Komisioni i Ligjeve*

9. P/Ligji "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin të sigurimeve dhe risigurimeve".

*-Komisioni i Ligjeve*

*-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

10. P/Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të sigurimeve".

*-Komisioni i Ligjeve*

*-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

11. P/Ligji "Për kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për organizimin e ndarjes Administrativo-Territoriale të Republikës së Shqipërisë.

*-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)*

*-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

*E Enjte, datë 8.07.2004, ora 10.00*

*-Seancë Plenare*

1. P/Ligji "Për miratimin e Kodit Detar Shqiptar".

*(Vijon në faqen 7)*

# Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

## *(Vijon nga faqja 6)*

2. P/Ligji “Për punën e Kuvendit në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian”
3. P/Ligji “Për disa shtesa në ligjin nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standartizimin”, të ndryshuar.
4. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” (paraqitur nga një grup deputetësh).
5. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Shërbimit Civil.
6. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Konkurrencës.

\*\*\*

## *E Hënë, datë 12.07.2004, ora 18.00*

### *-Seancë Plenare*

1. Mocion për debat me Kryeministrin, kërkuar nga një grup deputetësh, lidhur me zbatimin e objektivave të Qeverisë në zhvillimin e sektorit të telekomunikacioneve.

## *E Martë, datë 13.07.2004*

## *E Mërkurë, datë 14.07.2004*

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve :
1. P/Ligji “Për ratifikimin e Protokollit shtesë të Konventës për krimin kibernetik, për penalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobike, të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike”.  
*-Komisioni i Ligjeve*  
*-Komisioni i Jashtëm*  
*-Komisioni i Rendit*
  2. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8932, datë 25.7.2002 Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër

të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”.

*-Komisioni i Ligjeve*

*-Komisioni i Mbrojtjes*

3. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”.

*- Komisioni i Ligjeve*

*- Komisioni i Shëndetësisë*

4. P/Ligji “Për legalizimin e zonave informale”

*- Komisioni i Ligjeve*

*- Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacioneve*

*munikacioneve*

*- Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

*nancës*

*- Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit*

5. P/Ligji “Për legalizimin e ndërtimeve në ngulimet e reja komunitare në qytete” (paraqitur nga një grup deputetësh).

*- Komisioni i Ligjeve*

*- Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacioneve*

*munikacioneve*

*- Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

*nancës*

*- Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit*

6. P/Ligji “Mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kordinues Konsultativ në luftën kundër gjakmarrjes”.

*- Komisioni i Ligjeve*

*- Komisioni i Rendit*

*- Komisioni i të Drejtave të Njeriut dhe Minoritetit*

*dhe Minoritetit*

7. P/Ligji “Për sigurinë në anije dhe porte”.

*-Komisioni i Ligjeve*

*-Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacionit*

*munikacionit*

*-Komisioni i Rendit*

*E Enjte, datë 15.07.2004, ora 10.00*

*-Seancë Plenare*

1. P/Ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për kushtet e regjistrimit të anijeve” (Gjenevë, 7 shkurt 1986).
2. P/Ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për unifikimin e disa rregullave për transportin ajror ndërkombëtar”.
3. P/Ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit,ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e prodhimit dhe ristrukturimit të sektorit të energjisë”.
4. P/Ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e menaxhimit të integruar të ujërave dhe ekosistemit”.
5. P/Ligji “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.
6. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8932, datë 25.7.2002 Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”.
7. P/Ligji “Për ruajtjen e biodiversitetit”.
8. Dekret nr.4251, datë 26.06.2004 për dhënie pëlqimi për emërimin e znj.Vitore Tusha në detyrën e Anëtares së Gjykatës Kushtetuese, në vend të gjyqtarit Zija Vuci.

# Ftesë e Hapur për Bashkëpunim

(Vijon nga faqja 1)

Albtelekom Sh.A. dhe ARMO Sh.A. Kjo paketë, e cila sipas ligjeve të mësipërme do të miratohet nga Këshilli i Ministrave, është hartuar duke u bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare si dhe në funksion të një privatizimi sa më të suksesshëm me synim realizimin e një procesi transparent, me pjesëmarrje të gjerë dhe konkruuese i cili do të garantojë realizimin e investimeve të domosdoshme për zhvillimin afatgjatë të këtyre shoqërive dhe ekonomisë shqiptare. Nëpërmjet kësaj pakete aktesh nënligjore përcaktohen madhësia e paketës që do t'u ofrohet investitorëve strategjikë, kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e dy shoqërive dhe çështje të tjera që lidhen me përdorimin e të ardhurave nga procesi i privatizimit.

Duke vlerësuar rolin tepër të rëndësishëm që këto shoqëri kanë për ekonominë e vendit, Ministria e Ekonomisë, në kuadër të transparencës me publikun, hap këtë proces bashkëpunimi më të gjitha palët e interesuara për të dhënë kontributin e tyre në këtë drejtim.

Nëse ju jeni një organizatë, institucion, shoqatë, pedagog, student, jurist, ekonomist, inxhinier apo

çdo individ, brenda apo jashtë Shqipërisë, që mendoni se mund të jepni kontributin tuaj për përmirësimin ekësaj pakete të rëndësishme aktesh nënligjore, jeni të ftuar për të paraqitur idetë tuaja duke marrë pjesë në këtë bashkëpunim të hapur i cili do të vijojë dhe me një konferencë kombëtare mbi këtë temë, që do të zhvillohet së shpejti nga Ministria e Ekonomisë.

Për të marrë falas një kopje të paketës ju mund të:

Dërgoni një kërkesë me shkrim pranë Ministrisë së Ekonomisë.

Kërkoni me telefon ose faks në numrat tel 36 46 33 / 36 46 39 që një kopje t'ju vihet në dispozicion.

Dërgoni një mesazh elektronik në:

[privatizim\\_transparent@miek.gov.al](mailto:privatizim_transparent@miek.gov.al) dhe ne do t'ju përgjigjemi duke ju dërguar paketën në formë elektronike.

Kaloni pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe mund të merrni një kopje të paketës në zyrën nr.14, kati V.

Duke çmuar kontributin tuaj dhe falenderuar për bashkëpunimin, mirëpresim çdo sugjerim, koment apo vërejtje për këtë paketë aktesh nënligjore, të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe zhvillimin afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

## Njoftim

**Të nderuar zonja e zotërinj,** Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar të krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare "QSP" në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

"Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat. Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP."

### Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator

Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies

Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15

Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; [cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);

[www.ascdpd.org](http://www.ascdpd.org)